L I G J
Nr.7761, datë 19.10.1993

PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me termin "sëmundje ngjitëse" do të kuptohet grupi i sëmundjeve që shkaktohen nga mikroorganizma dhe parazitë sëmundjshkaktues që transmetohen drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga njeriu i sëmurë ose bartësi te njeriu i shëndoshë (antroponozat) dhe nga kafshët e produktet blegtorale te njerëzit (antropozoonozat).

Neni 2

Parandalimi e luftimi i sëmundjeve ngjitëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshëm.

Neni 3

Parandalimi dhe luftimi i sëmundjeve ngjitëse organizohet dhe drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe përfshin kompleksin e masave për zbulimin në kohë, evidentimin e shfaqjes, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.

Neni 4

Strukturat e shërbimit për luftimin e sëmundjeve ngjitëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe në institucionet vartëse të saj përcaktohen dhe miratohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

Strukturat organizative për parandalimin e luftimin e sëmundjeve ngjitëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ministrinë e Rendit Publik përcaktohen në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 5

Shërbimet e luftës kundër sëmundjeve ngjitëse pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, në Institutin Kërkimor të Higjienës dhe Epidemiologjisë, në Drejtorinë e Shëndetit Publik, si dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Bujqësisë dhe Spitalin Qendror të Ushtrisë, janë struktura shtetërore të specializuara që kontrollojnë zbatimin e ligjshmërisë në këtë fushë, në:

a) institucionet e shërbimit shëndetësor në të gjitha nivelet shtetërore ose private;

b) strukturat e shërbimit shëndetësor në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ato të Rendit

Publik;

c) strukturat e shërbimit veterinar në qendër e në bazë;

d) sektorë shtetërorë ose privatë dhe veprimtaritë e personave fizikë e juridikë të të gjitha llojeve, ku rrezikohet përhapja e të gjitha sëmundjeve ngjitëse.

Punonjësit e këtyre shërbimeve janë persona të specializuar.

Neni 6

Drejtoria e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, mbështetur nga Instituti Kërkimor i Higjienës dhe Epidemiologjisë e në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Veterinare, si dhe nga shërbimet e epidemiologjisë në rrethe, studion, analizon dhe përgjithëson në mënyrë shkencore situatën epidemiologjike të vendit dhe përcakton zgjidhjet e strategjitë për përmirësimin e vazhdueshëm të saj.

Neni 7

Të gjitha strukturat e shërbimit shëndetësor parësor, si mjeku i familjes, poliklinikat, dispancerit, qendrat shëndetësore, këshillimoret, ambulancat periferike e qendrat kurative kanë për detyrë:

a) Të evidenojnë gjendjen e sëmundjeve ngjitëse në territorin që mbulojnë dhe të zbatojnë masat që përcaktohen në këtë ligj.

b) Të përgatitin plankërkesat për medikamente dhe bazën materiale të nevojshme, si dhe të zbatojnë skemat për imunizimin e popullsisë, mjekimin dhe mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse.

c) Të informojë rregullisht për rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe mbulesën vaksinale në shërbimet përkatëse epidemiologjike.

ç) Të bashkëpunojnë me shërbimet e specializuara të higjenës dhe të luftës kundër sëmundjeve ngjitëse në rreth, me shërbimin veterinar, me organet e pushtetit lokal dhe me shoqata të ndryshme për përmirësimin e kushteve higjeniko-shëndetësore të mjedisitë familjar dhe atij komunitar dhe për ngritjen e nivelit të njohurive shëndetësore të popullatës.

Neni 8

Organet e shëndetësisë të të gjitha niveleve detyrohen të informojnë rregullisht për situatën e sëmundjeve ngjitëse e masat parandaluese, organet e pushtetit lokal në territorin ku veprojnë.

Organet e pushtetit lokal detyrohen të mbështesin veprimtarinë e punonjësve të shëndetësisë për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, të parashikuara në këtë ligj.

KREU II
PËR MASAT E LUFTIMIT E SËMUNDJEVE NGJITËSE

Neni 9

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, në rast përhapjeje masive të sëmundjeve ngjitëse, është e detyruar të marrën masa të emergjencës, të cilat përcaktohen në akte nënligjore.

Neni 10

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit mbulon shpenzimet, brenda buxhetit vjetor të parashikuar për sigurimin e preparateve imunobiologjike, medikamenteve dhe bazës tjetër materiale të domosdoshme për parandalimin, diagnostifikimin dhe mjekimin e sëmundjeve ngjitëse, sipas nevojave të institucioneve shëndetësore.

Për garantimin e masave parandaluese dhe mjekuese të sëmundjeve ngjitëse, përfitojnë mjekime, analiza e vaksina gratis një kategori personash të sëmurë dhe persona të tjerë, të Përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Ministri i Shëndetësisë dhe i Ruajtjes së Mjedisit propozon dhe i kërkon Këshillit të Ministrave mbështetje financiare për raste të jashtëzakonshme epidemike.

Neni 11

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit organizon dhe drejton shërbimin sanitaro-antiepidemik në pikat e kalimit kufitar detar, ajror e tokësor, në përshtatje me trafikun dhe situatën epidemiologjike, për të siguruar parandalimin e hyrjes së sëmundjeve të rrezikshme të Konventës, në përputhje me normat e përcaktuara në rregulloren sanitare ndërkombëtare.

Neni 12

Denoncimi dhe regjistrimi i sëmundjeve ngjitëse të vërtetuara ose të dyshuara e bartesit e tyre bëhen pranë shërbimit të luftës kundër sëmundjeve ngjitëse në Drejtorinë e Higjenës dhe e Epidemiologjisë dhe në drejtoritë e shëndetit publik të rrethit nga të gjitha institucionet shëndetësore, shtetërore ose private, si spitalet infektive dhe joinfektive, poliklinikat, dispanceri, qendrat shëndetësore, mjeku i familjes dhe nga mjekët e institucioneve shkollore e parashkollore.

Neni 13

Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitese, institucionet shëndetësore që përcaktohen në nenin 12, detyrohen të marrin masa për zbulimin në kohë, shtrimin në spital ose trajtimin në shtëpi, izolimin e vaksinimin në përputhje me rregullat përkatëse.

Institucioni shëndetësor ose privat që ka bërë denoncimin dhe mjekimin e të sëmureve me sëmundje ngjitëse, është i detyruar të njoftojë edhe për përfundimin e sëmundjes.

Neni 14

Për të gjitha sëmundjet ngjitëse që transmetohen nga kafshët në njerëz (zoonozat) bëhet njoftimi i ndërsjellë ndërmjet organeve shëndetësore e veterinare të të gjitha niveleve, shtetërore ose private, dhe bashkëpunohet për marrjen e masave antiepizootike dhe antiepidemike, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr.7674, datë 23.2.1993 "Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar".

Neni 15

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton me akte nënligjore:

a) Listën e sëmundjeve ngjitëse që duhet të denoncohen, regjistrohen dhe raportohen.

b) Mënyrën e denoncimit të sëmundjeve ngjitëse.

c) Llojet e sëmundjeve ngjitëse, mjekimi i të cilave duhet të bëhet detyrimisht në spital.

ç) Masat e përgjithshme a të veçanta për secilën sëmundje ngjitëse, duke përfshirë edhe ato të luftimit të brejtësve dhe insekteve, kur paraqesin indikacion epidemiologjik.

d) Dokumentacionin e nevojshëm për denoncimin, regjistrimin, anketimin e sëmundjeve ngjitëse dhe vaksinimin.

Neni 16

Në rast shfaqjeje të sëmundjeve ngjitëse, epidemiologët, ndihmësepidemiologët dhe punonjësit e tjerë të ngarkuar për zbatimin e masave parandaluese e mjekuese, kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë në ndërmarrje, institucion shtetëror ose privat dhe reparte ushtarake, ndërsa në banesë vetëm për të shmangur një rrezik të atypëratyshëm për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për të bërë hetimin epidemiologjik, izolimin, shtrimin në spital, mbikëqyrjen shëndetësore të kontakteve, vaksinimin, depistimin, dezinfektimin e mjekimin profilaktik.

Kur punonjësit e mësipërm hasin pengesa në kryerjen e detyrës, kërkojnë mbështetjen e organeve të rendit publik.

Subjektet që kanë të drejtë të hyjnë në objektet e mësipërme, përcaktohen nga Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe pajisen me librezë identiteti.

Neni 17

Me kërkesën e shërbimeve të specializuara për luftën kundër sëmundjeve ngjitëse, organet e rendit publik janë të detyruara të ndihmojnë, sa herë që hasen pengesa, për plotësimin e detyrave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 18

Drejtuesit ose pronarët, vendas a të huaj, të ndërmarrjeve, objekteve ose institucioneve shtetërore, shoqërore ose private, si dhe shtetasit, janë të detyruar të zbatojnë detyrat e lëna nga epidemiologët dhe ndihmësepidemiologët, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, kur në mjedisin e objekteve të mësipërme është shfaqur qoftë edhe një rast me sëmundje ngjitëse.

Neni 19

Për të ndjekur organizimin dhe masat e luftimit të lebrës në shkallë vendi ngarkohet klinika e sëmundjeve të lëkurës pranë Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës, e cila bashkëpunon me shërbimet epidemiologjike dhe dispanceritë përkatëse të rretheve.

Neni 20

Për parandalimin dhe luftimin e SIDA (AIDS) ngrihen komisioni kombëtar dhe institucionet e tjera shëndetësore në nivel kombëtar e lokal, veprimtaria e të cilave drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 21

Qendrat e dhurimit të gjakut janë të detyruara të bëjnë kontrollin shëndetësor paraprak (laboratorik) të gjithë dhuruesve, sa herë që ata paraqiten për të dhuruar gjak. Përjashtohen përgjithmonë si dhurues të gjakut personat që kanë rezultuar seropozitive me SIDA (AIDS) hepatit viral, malarje ose me sëmundje të tjera që transmetohen me anë të gjakut a të nënprodukteve të tij.

Neni 22

Institucionet shëndetësore shtetërore ose private janë të detyruara të zbatojnë normat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për sterilizimin dhe dezinfektimin e mjeteve të përdorimit kirurgjikal dhe medikosanitar.

KREU III

MASA PËR IMUNIZIMIN E POPULLSISË

Neni 23

a) Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit harton dhe zbaton programin e gjerë të imunizimit (vaksinimit).

b) Pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit ngrihet "Komiteti Kombëtar i Imunizimit", si organ konsultativ që përcakton politikën e vaksinimit në shkallë vendi.

c) Ministria e Shëndetësisë përcakton kalendarin e vaksinimit të detyrueshëm kundër sëmundjeve të difterisë, kollës së mirë, tetanozit, fruthit, poliomielitit, tuberkulozit, si dhe mënyrën e ruajtjes, të transportimit dhe të aplikimit të vaksinave.

Neni 24

Vaksinimi i detyrueshëm realizohet në moshat 0-15 vjeç dhe në gratë shtatzëna nga këshillimoret, mjeku i familjes, nga ambulancat dhe qendrat shëndetësore.

Institucionet e mësipërme jane të detyruara të sigurojnë evidencimin e saktë të kontigjenteve që i nënshtrohen vaksinimit, planin e vaksinimit dhe sasitë e nevojshme të vaksinave të ruajtura në kushtet e "zinxhirit të ftohtë".

Neni 25

Institucionet shëndetësore që janë ngarkuar me vaksinimin, janë të detyruara të pajisin me librezën e vaksinimit gjithë personat që i nënshtrohen vaksinimit. Libreza e vaksinimit kërkohet dhe plotësohet sa herë që aplikohen vaksinat.

Neni 26

Për çdo ndryshim që bëhet në vendbanim, brendapërbrenda rrethit ose jashtë rrethit, zyra e gjendjes civile nuk mund të bëjnë asnjë regjistrim, pa pasur dokumentin zyrtar të firmosur nga titullari i institucionit shëndetësor (poliklinikës, qendrës shëndetësore) që të vërtetojnë regjistrimin në këshillimore ose në ambulancë të fëmijëve që i përkasin secilës familje që transferohet.

Neni 27

Për çdo fëmijë që hyn për herë të parë në shkollë (6-7 vjeç), detyrohet pajisja e tij prej institucioneve shëndetësore me një dokument që provon vaksinimin e kryer sipas kalendarit. Kërkesa e këtij dokumenti dhe ruajtja e tij nga drejtoritë përkatëse të shkollave është i detyrueshëm.

Neni 28

Për të penguar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse që nuk përfshihen në nenin 23, shkronja "e", Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit organizon kryerjen e vaksinimit me indikacion epidemiologjik, si dhe për qëllimet e udhëtimit ndërkombëtar.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 29

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Mosdenoncimi, mosregjistrimi i sëmundjeve ngjitëse, mosraportimi i tyre dhe i vaksinimeve, dënohen me gjobë nga 200-1000 lekë.

2. Mosmarrja e masave në vatrat e infeksionit, si anketimi, shtrimi në spital, kur është përcaktuar i detyrueshëm, largimi nga kolektiviteti (çerdhe, kopësht, shkollë, azil, spital etj.), desinfektimi, dezinsektimi, deratizimi, vaksinimi, mjekimi profilaktik e observimi dënohen me gjobë nga 300-3000 lekë.

3. Moszbatimi i kalendarit të vaksinimit të detyrueshëm, mosregjistrimi i personave që duhen vaksinuar, mosmbajtja në kushtet e "zinxhirit të ftohtë" të vaksinave, falsifikimi dhe korrigjimi i dokumenteve të vaksinimit dënohen me gjobë nga 500-5000 lekë.

4. Moskryerja e analizave laboratorike, diagnostikuese, profilaktike dhe të rikontrollit dënohet me gjobë nga 200-5000 lekë.

5. Përdorimi i materialeve medikosanitare të pasterilizuara dhe të rikontrollit dënohet me gjobë nga 500-5000 lekë.

Masa më e vogël e dënimit është deri 200 lekë.

Kur shkeljet administrative sjellin pasoja të rënda në shëndetin e njerëzve, çështja dënoncohet për ndjekje penale në organet e prokurorisë.

Neni 30

Për kundërvajtjet administrative të parashikuara sipas nenit 29 të këtij ligji dënimet me gjobë jepen nga:

1. Mjekët epidemiologë dhe inspektorët e sektorit të mjekësisë parandaluese në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

2. Epidemiologët dhe nd/epidemiologët e rrethit, të Institutit të Higjenës dhe Epidemiologjisë, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Rendit Publik.

3. Persona të tjerë të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e mbrojtjes së Mjedisit.

Subjektet e mësipërme pajisen me librezë identiteti.

Neni 31

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi kundër vendimeve të dënimit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 32

Dekreti nr.1894, datë 5.7.1954 "Për luftimin e sëmundjeve ngjitese", ndryshuar me dekret nr.4360 datë 16.1.1968 dhe nr.5439, datë 15.10.1976, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.672, datë 29.10.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.